



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIAL
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR



QENDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE
TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Nr. 8834 Prot. Datë 15.11 2024

Nr. 0597 Prot. Datë 15.11 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR (SHSSH)

dhe

QËNDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

QENDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI (CRCA/ECPAT SHQIPËRI), përmes shërbimit të saj të specializuar **iSIGURT.al – Linja Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet**. Linja iSIGURT.al është një hapësirë e sigurtë që komunikon me fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe institucionet për të adresuar dhe trajtuar rastet e bullizmit, të dhunës fizike dhe psikologjike, si dhe dhunës e shfrytëzimit seksual, si dhe për të ndihmuar në mbylljen, fshirjen apo bllokimin e faqeve dhe përmbajtjeve të papërshtatshme që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR (SHSSH), është institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, me seli në Tiranë. Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në VKM nr.135, datë 7.3.2018, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, ka si mision të sigurojë ofrimin cilësor të shërbimeve për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- Me synimin e përbashkët për mbështetjen dhe informimin e sistemit të shërbimeve shoqërore në nivel vendor, mbi çdo formë të dhunës dhe bullizmit ndaj fëmijëve dhe të rinjve në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme;
- Me qëllimin për të forcuar sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, trajnimin e personelit të njësive të qeverisjes vendore për këto shërbime, përfshirjen në planet sociale të çështjes së mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale, si një ndër fushat e reja të shërbimeve shoqërore;
- Me angazhimin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin tonë për të përgatitur rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve të cilët marrin shërbime në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror;
- Me bindjen se ky bashkëpunim nxit dhe promovon respektin për të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve, e në mënyrë të veçantë interesin më të lartë të fëmijës;

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim:

- Vendorsjen e bashkëpunimit midis SHSSH dhe CRCA/ECPAT Shqipëri për organizimin e trajnimeve, workshopeve dhe sesioneve informuese për forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe njësive të qeverisjes vendore për çështjet e mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme;

NENI 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me:

- Ligjin 121/2016 “Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjin Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (2024-2030)
- Paktin Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna në Hapësirën Kibernetike;

NENI 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 2 vjeçare dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët. Marrëveshja mund të rinovohet në përfundim të periudhës së përcaktuar.

NENI 4

Parimet e Bashkëpunimit

Palët respektojnë të drejtën e privatësisë, konfidencialitetit dhe mbrojtjes të të dhënave personale gjatë punës së tyre.

Palët, gjatë bashkëpunimit të tyre, udhëhiqen nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

NENI 5

Përgjegjësitë e palëve në marrëveshje

Për realizimin e objektit dhe qëllimit të marrëveshjes palët bien dakord për sa më poshtë:

Përgjegjësitë e SHSSH:

- Bashkë-organizon sesionet e informimit të sistemit dhe profesionistëve të shërbimeve shoqërore në nivel vendor, mbi çdo formë të dhunës dhe bullizmit ndaj fëmijëve dhe të rinjve në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme;
- Koordinon punën me CRCA/ECPAT Shqipëri për organizimin e trajnimeve dhe workshopeve për forcimin e kapaciteteve ku në planet sociale të përfshihet edhe çështja e mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale, si një ndër fushat e reja të shërbimeve shoqërore;

- Në bashkëpunim me CRCA/ECPAT Shqipëri përgatisin rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve në shërbimet shoqërore, përfshi përfshirjen në planet sociale të masave për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale;
- Bashkë-organizon fushata ndërgjegjësuere për informimin e fëmijëve dhe të rinjve që marrin shërbime në IPSH, prindërve, shërbim-ofruesve etj., mbi shërbimet ekzistuese apo ato të reja për mbrojtjen në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme nga çdo formë e dhunës dhe bullizmit.

Përgjegjësitë e CRCA/ECPAT Shqipëri:

- Të përgatisë në konsultim me SHSSH materialet informuese të nevojshme dhe bashkë-organizojnë sesionet e informimit për sistemin dhe profesionistët e shërbimeve shoqërore në nivel vendor, mbi çdo formë të dhunës dhe bullizmit ndaj fëmijëve dhe të rinjve në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme;
- Të përgatisë dhe të konsultojë Manualin e Trajnimit dhe të koordinojë punën me SHSSH për organizimin e trajnimeve dhe workshopeve për forcimin e kapaciteteve ku në planet sociale të përfshihet edhe çështja e mbrojtjes dhe kujdesit të fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale, si një ndër fushat e reja të shërbimeve shoqërore;
- Në bashkëpunim me SHSSH përgatisin rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve në shërbimet shoqërore, përfshi përfshirjen në planet sociale të masave për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe dëmtimet në hapësirën dixhitale;
- Të përgatisë dhe të konsultojë materialet dhe mesazhet me SHSSH për fushatat e përbashkëta ndërgjegjësuere për informimin e fëmijëve dhe të rinjve që marrin shërbime në IPSH, prindërve, shërbim-ofruesve etj., mbi shërbimet ekzistuese apo ato të reja për mbrojtjen në hapësirën dixhitale dhe në jetën e përditshme nga çdo formë e dhunës dhe bullizmit.

NENI 6

Përfundimi i Marrëveshjes

Secila palë ka të drejtën të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen e bashkëpunimit duke njoftuar palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit.

NENI 7
Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale të firmosura nga palët, nga dy kopje për secilën palë, të firmosura nga titullarët dhe të vulosura me vulat zyrtare të institucioneve pjesëmarrëse. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Shërbimi Social Shtetëror



Znj. Reme XHO

Znj. Reme XHO
Drejtor i Përgjithshëm

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA / ECPAT Shqipëri)



Altin HAZIJAJ

Altin HAZIJAJ
Drejtor Ekzekutiv